Numri i arketimeve sipas kategorimve

NJ OSIA	GJ ITOS E J	Amvisni	Biznese	Institucione	OJ Q	Te paident.
DP01	2.00	2.00	.00	.00	.00	.00
F001	1.00	1.00	.00	.00	.00	.00
FA01	1.00	1.00	.00	.00	.00	.00
ID01	1.00	.00	1.00	.00	.00	.00
Njesia Istog	22,226.00	19,962.00	1,767.00	497.00	.00	.00
Njesia J unik	5,358.00	4,789.00	419.00	150.00	.00	.00
KL.	1.00	1.00	.00	.00	.00	.00
Njesia Kline	13,946.00	11,973.00	1,603.00	370.00	.00	.00
Menaxhmenti	29.00	29.00	.00	.00	.00	.00
NE01	4.00	4.00	.00	.00	.00	.00
P201	2.00	2.00	.00	.00	.00	.00
Njesia PEJ E	101,310.00	90,133.00	9,504.00	1,648.00	25.00	.00
Projekti Fashti Brestovik-Peje	3.00	3.00	.00	.00	.00	.00
PW01	1.00	1.00	.00	.00	.00	.00
SK01	1.00	1.00	.00	.00	.00	.00
Totali :	164,330.00	146,635.00	14,716.00	2,954.00	25.00	.00

Sasia e ujit t' faturuar (m3) - pa pages¹

NJ OSIA	GJ IT OSEJ	Amvisni	Biznese	Institucione	OJ Q	Te paident.
Njesia De ´an	36,505			36,505		
Njesia Istog	2,971			2,971		
Njesia J unik	1,181			1,181		
Njesia Kline	330			330		
Njesia PEJ E	114,695			114,695		
Totali :	155,682			155,682		

Klient' t e ri

NJ OSIA	GJ IT OSEJ	Amvisni	Biznese	Institucione	OJ Q	Te paident.
Njesia De ´an	312	256	56			
Njesia Istog	526	480	45	1		
Njesia J unik	47	43	3	1		
Njesia Kline	211	191	20			
Njesia PEJ E	1,585	1,451	130	4		
Totali :	2,681	2,421	254	6		

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

në KRU "Hidrodrini" Sh.A. Pejë

Zyra e Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidrodrini" Sh.A. gjatë vitit 2025, në mungesë të Bordit të Drejtorëve dhe rrjedhimisht Komisionit të Auditimit , nuk ka mbajtur asnjë takim të rregullt me Komisionin e Auditimit.

Sipas Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 kanë qenë të planifikuara për tu audituar, njësitë , auditimet si më poshtë:

- Auditimi në Departamentin Teknik, Laboratorët, auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dala nga DAK-u,
- Auditimi në Departamentin Komercial, inkasimi , faturimi, menaxhimi i lëndëve në procedurë përmbaremore,
- Auditimi në Departamentin Financiar,
- Auditimi i Zyrës së Prokurimit,
- Auditimi në Departamentin e Administratës , menaxhimi i automjeteve zyrtare.

Të gjitha auditimet janë përfunduar, mirëpo kanë ngelur të pa aprovuara/miratuara nga Komisioni i Auditimit.

\

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Raport vjetor për vitin 2025 nga zyra e Teknologjisë Informative

Parathënie

Gjatë vitit 2025, Zyra e TI-së me personelin e saj ka vazhduar që të ofrojë mbështetje për të gjithë personelin e Kompanisë kurdoherë që ajo ka qenë e nevojshme.

Personeli i zyrës së TI-së ka mbështetur procese dhe zhvillime të ndryshme në kuadër të kompanisë sonë.

Zyra e TI-së ka nisur dhe zbatuar projekte të ndryshme e gjithashtu ka ofruar mbështetje në zbatimin e atyre të nisura nga departamentet tjera.

Kemi kontribuar me sukses në realizimin e projekteve të ndryshme sikurse:

- digjitalizimin e pjesës së shërbimit për pagesën e faturave përmes lansimit të aplikacionit “eHidrodrini” për kryerjen e pagesave nga konsumatorët përmes telefonëve dhe pajisjeve “smart” – në bashkëpunim të ngushtë me Kryeshefin Ekzekutiv dhe kompaninë “Informatika Computers”,
- hartimin e faturës së re, pra: përmbajtjes dhe paraqitjes së të dhënave në faturën e re (e cila shtypet nga lexuesit në terren) për konsumatorët, përgatitjen dhe dhënien e shtypësve termik për lexuesit në terren – në bashkëpunim të ngushtë me kompaninë “Informatika Computers” dhe departamentin komercial,
- përgatitjen dhe dhënien në përdorim të telefonëve të ri për disa nga lexuesit në terren,
- përgatitjen dhe dhënien në përdorim të kompjuterëve të ri për një pjesë të personelit,
- avansimet në përmbajtjen e ueb-faqes së kompanisë në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv, Sekretarin e Kompanisë dhe Zyrтарin e Prokurimit,
- procesin e digjitalizimit të dokumentacionit zyrtar të kompanisë në bashkëpunim të ngushtë me Kryeshefin Ekzekutiv dhe Sekretarin e Kompanisë,
- mbulimin e disa hapësirave me kamera (autonome) të vëzhgimit,
- intervenime në kabllim të rrjetës së brendshme “LAN”,
- ndrrimin e furnizuesit me shërbimet e Internetit (“ISP”) në shumë lokacione dhe konfigurimet e nevojshme në pajisjet tona,
- si dhe projekte të tjera.

Më e rëndësishmja është që, përkundër sfidave që lidhen me rritjen e vazhdueshme të kërcënimeve kibernetike e kur shtojmë këtu edhe kufizimet tona në pikëpamjen “harduerike” dhe “softuerike” si zyrë e TI-së, kemi arritur që ta ruajmë stabilitetin dhe efikasitetin e sistemeve dhe shërbimeve tona përgjatë tërë kësaj periudhe. Me plot kuptimin e fjalës mund të pohojmë se zyra e TI-së është një prej shtyllave kryesore në përbërjen e Kompanisë sonë.

Shfrytëzojmë rastin të falënderojmë menaxhmentin për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin me zyrën tonë.

Në vazhdim, në formë të përmbledhur po i përmendim disa nga aktivitetet më të rëndësishme përgjatë kësaj periudhe.

1. Prokurimi i pajisjeve të TI-së

Meqenëse puna është më efektive kur ne kemi pajisje dhe vegla të duhura në dispozicion e konsideroj si të arsyshme që të nisi këtë raport duke përmendur fillimisht blerjet përmes prokurimit gjatë vitit.

Sipas procedurave të rregullta të prokurimit është realizuar me sukses procesi i tenderimit për blerjen dhe furnizimin me disa pajisje të TI-së në fund të vitit 2024, derisa dorëzimi i tyre të ne është kryer në fillim të vitit 2025. Në vazhdim po i paraqesim pajisjet dhe sasinë e blera përmes këtij tenderi:

- | |
|---|
| <ul style="list-style-type: none">• x 10 kompjuterë (“desktop computer”),• x 10 monitorë,• x 10 “laptopë”,• x 10 telefona të mençur (për leximet e ujëmatësve nga ana e inkasantëve),• x 5 IP telefona për zyrat tona,• x 2 Televizorë të mençur (“Smart TV”). |
|---|

Të gjitha procedurat për tenderin për marrjen me qira të shërbimeve të shtypjes/”printimit”, kopjimit dhe skanimit janë përfunduar me sukses dhe është përzgjedhur OE fitues. Projekti është në zbatim e sipër.

- Kontrata kap vlerën 6,625.70 Euro dhe është e vlefshme për periudhën maksimale deri në **18 muaj**. Marrja me qira e shërbimeve të shtypjes dhe fotokopjimit është dëshmuar të jetë sa produktive aq edhe ekonomike për kompaninë tonë. Kur marrim parasysh kohëzgjatjen e kësaj kontrate, kuptojmë që në muajin Maj ose më së largu në muajin Qershor të këtij viti do të duhet të përsëritet edhe shpallja e një tenderi të tillë.

Në fund të vitit 2025 e kemi nisur edhe një tender për furnizim me pajisje të TI-së i cili do të fillojë së zbatuari në muajt e parë të vitit 2026.

Lot 1, përmban furnizimin me:
x 1 Server profesional
x 12 module të RAM memorjes për serverët ekzistues
x 10 kompjuterë
x 10 monitorë
Lot 2, përmban furnizimin me:
• x 4 Pajisje të rrjetit – “PoE Switch”
• x 4 Pajisje të rrjetit – “Omni Directional Access Point”

Për Lot 1 janë kryer me sukses të gjitha procedurat dhe është nënshkruar kontrata, **derisa për Lot 2 ka dështuar procesi i prokurimit për arsye se nuk ka pasur oferta të suksesshme nga OE.**

Lot 1 do të realizohet në muajt e parë të vitit 2026 sipas afateve të parapara në këtë tender. Derisa për pajisjet e parapara në Lot 2 gjatë vitit do të shpallet edhe një tender tjetër, ose do të kombinohen këto pajisje me tenderin që do ta shpallim për furnizimin dhe instalimin e sistemeve të vëzhgimit me kamera në disa lokacione, përkatësisht: ITUN, depo Istog, dhe hapësirat e objekteve të Burimi në Istog.

2. Pajisjet dhe programet e TI-së dhe siguria

2.1 Pajisjet dhe programet e TI-së

E fillova këtë raport me investimet që janë duke ndodhur në vazhdimësi në fushën e TI-së me theks të veçantë gjatë këtyre tre viteve të fundit. Këto pajisje janë mjete pune, pra janë thelbësore për punë. Shfrytëzojmë rastin të falënderojmë menaxhmentin për mirëkuptimin dhe miratimin e këtyre projekteve.


Pajisjet e përmendura sipër në pikën 1.1, i kemi përgatitur me programet dhe konfigurimet e nevojshme dhe i kemi dorëzuar tek përdoruesit. Shpërndarja e tyre është bërë duke u bazuar në gjendjen dhe vjetërsinë e tyre, e për të cilat ndryshime është marr fillimisht pëlqim nga Kryeshefi Ekzekutiv.

2.2 Siguria

Për të gjithë kompjuterët që i blejmë përmes prokurimit blejmë edhe licensën për Sistemin Operativ. Kjo padyshim që paraqet një kosto mirëpo është kërkesë minimale në kuptimin e sigurisë, pasi që këto sisteme përmes azhurnimeve arnohen dhe kanë nivel më të lartë të mbrojtjes e me këtë të sigurisë.

Pajisjet mbrojtëse – “Fortigate Firewall” na mundësojnë që të mbrohemi përmes filtrimit dhe skanimit të trafikut që gjenerohet nga dhe drejt pajisjeve tona e që kalon përmes tyre. Këto pajisje janë konfiguruar fillimisht në vitin 2023 nga kontraktori “InterAdria” i cili ka qenë përgjegjës për furnizimin dhe konfigurimin e tyre duke aktivizuar edhe licensën, ndërsa që nga ajo kohë ne vazhdojmë me mirëmbajtjen dhe konfigurimet e tyre. Licensa mundëson që të freskohet databaza e këtyre pajisjeve mbi kërcënimet më te reja që paraqiten në botë secilen ditë.

Së voni, me ndryshimet që i kemi bërë në rrjetën tonë të përmendura më poshtë në pikën 1.3.1 pra me rastin e kalimit të furnizimit me shërbimet e internetit nga IPKO në Telekom i Kosovës na është dashur që të kryejmë mjaft konfigurime të cilat i kemi realizuar me sukses. Në vazhdim, po i paraqesim disa statistika nga këto pajisje.



Figurat 1 dhe 2 paraqesin pamje nga pajisjet “fortigate firewall”.

Krahas pajisjeve të mësipërme që kanë edhe funksionin e murit mbrojtës në kompaninë tonë ka vite që përdorim programin e mbrojtës nga virusët etj., të quajtur “Trellix” (ish-McAfee).




Figura 3: Paraqet statistika si dhe veprimet e ndërmarra nga programi “Trellix” për rreziqet potenciale për periudhën prej dy (2) javëve.

Për aq sa jemi të vetëdijshëm përkundër sfidave të vazhdueshme e sidomos tash në këtë kohë kur secilen ditë po lexojmë dhe dëgjojmë se shumë nga kompanitë prestigjioze janë duke u ballafaquar me probleme të mëdha dhe humbjen e kontrollit si rezultat i sulmeve me vegla të reja të krijuara përmes Inteligjencës Artificiale, ne nuk kemi ndonjë rast të cenimit të sigurisë për të raportuar përgjatë kësaj periudhe, por kjo kursesi nuk do të thotë që ne jemi të sigurtë.

Incidentet: me datë 18 nëntor 2025 pas kontrolleve e kemi vërtetuar që “serveri” kryesor në të cilin qëndrojnë bazat-e të të dhënave (databazat) e programit “Rikont” ka pësuar kolaps pra defekt serioz. Fatmirësisht, ne kemi në përdorim sistemin “Veeam Backup and Replication Community Edition” në të cilin ruhen kopjet rezervë (jo vetëm si kopje por si “Server” Virtual - që d.m.th. ruhet i tërë “Serveri” në formën e imazhit), dhe kjo na ka mundësuar që ta bëjmë me sukses të plotë rikthimin “Serverit” e me këtë edhe të gjitha të dhënave nga kopja e ditës së mëparshme e krijuar në orën 17:00h (pra pas orarit të punës) - proces ky i cili mori shumë kohë por që përfundoi me sukses. Ky sukses i plotë u konfirmua edhe nga programet e kompanisë Informatika, pasi që i vërtetuan të dhënat si dhe funksionimin e programit të tyre. Përkundër që e kaluam këtë sfidë, lirisht ne mund të themi se ishim me shumë fat kësaj rradhe dhe ia arritëm që me sukses brenda një periudhe më të shkurtër se 24 orë ta kthejmë në funksion sistemin dhe shërbimet. Më pas, kam dërguar e-mail te i gjithë personeli përkatës me instruksionet për punët pasuese si rezultat i këtij defekti.

3. Furnizuesit me shërbimet e internetit, pajisjet e rrjetit, ormanët metalik dhe kamerat

3.1 Furnizuesit me shërbimet e internetit

Gjatë vitit 2025 kemi pasur bashkëpunim shumë të suksesshëm me Telekomin e Kosovës. Ata kanë investuar mjete dhe punë dhe kanë zgjeruar mbulueshmërinë me furnizimin me Shërbimet e Internetit në tërë territorin në të cilin ne veprojmë. Kështu, ata gradualisht kanë filluar që të na përgjigjen në kërkesat tona që i kemi parashtruar ndër vite.

Si rezultat këto në vazhdim tashmë janë të gjitha lokacionet/pikat të cilat mbulohen me furnizim me shërbimet e internetit nga **Telekomi i Kosovës**:

1. Zyrat Qendrore – lidhja kryesore - “linku primar”,
2. Rezervuari – lidhje speciale përmes rrjetës 5G me përdorim të kartelës SIM (pa kufizim në GB) – ky është një produkt i ri nga Telekomi i Kosovës dhe për ne ka qenë zgjidhje ideale për këtë lokacion,
3. Arka - në objektet e zyrave të vjetra – në çarshinë e gjatë,
4. Arka - sporteli në objektin e komunës së Pejës,
5. Arka – afër stacionit të policisë së trafikut – qytetin e Pejës,
6. Arka – Vitomericë,

7. Zyrtar e administratës – njësia operative Deçan,
8. Arka – në qendër të qytezës, afër pompës së derivateve,
9. Zyrtar e administratës – njësia operative Junik,
10. Zyrtar e administratës – njësia operative Klinë,
11. Objektet e fundërruesit – njësia operative Klinë,
12. Zyrtar e vjetra të administratës – njësia operative Istog,
13. Zyrtar e reja të administratës – njësia operative Istog,
14. Depoja e njësisë operative Istog,
15. Objekti i klorinimit – Vrellë, njësia operative Istog,
16. Objektet te Burimi i Istogut, njësia operative Istog.

Kështu gradualisht e kemi ndërprerë furnizimin me shërbimet e internetit nga operatori **IPKO** për shumë nga pikat e sipër-përmendura. Megjithatë, mbesin akoma edhe këto pika/lokacione që i konsiderojmë shumë të rëndësishme dhe për të cilat do të vazhdojmë që ta kemi edhe lidhjen me operatorin IPKO (në disa raste si lidhje e dyfishtë).

1. Zyrtar Qendrore (lidhje e dyfishtë),
2. Arka - në objektet e zyrave të vjetra – në çarshinë e gjatë (lidhje e dyfishtë – kjo për shkak të vëllimit të punës aty andaj nuk dëshirojmë që t’ia lëmë rastit në rast se dështon lidhja me telekom),
3. Objektet e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura – ITUN (lidhje primare dhe e vetme pasi që aktualisht asnjë operator tjetër nuk është në gjendje që të na furnizojë me shërbime në këtë lokacion).

Shënim: me këto ndryshime të sipërpërmendura si rezultat i krijimit të kushteve nga ana e Telekomit të Kosovës, deklarojmë se janë ulur ndjeshëm shpenzimet operative sa i përket faturës për furnizimin me shërbimet e internetit.

Krahas Telekomit dhe IPKO-së i kemi edhe dy (2) operatorë të tjerë që na furnizojnë me shërbimet e internetit:

1. Shtëpia e rojtarit, Burimi Drini i Bardhë, Radavc - furnizohemi nga një kompani private që vepron në atë trevë e quajtur “Optimum Telecommunication LLC”.
2. Objekti i klorinimit, afër Burimit Drini i Bardhë, Radavc - furnizohemi nga “Optimum Telecommunication LLC”, dhe
3. Objektet në lokacionin burimi Uji i Zi, - furnizohemi nga operatori “Telkos”.

Për këto tre (3) pika asnjë operator nuk është në gjendje që të ofrojë shërbim deri më tani.

3.2 Pajisjet e rrjetit

Përmes Lot 2 të tenderit që e përmendëm sipër kishim planifikuar që të mbulojmë me lidhjen e internetit pa tel (Wi-fi) hapësirat dhe objektet e ITUN, por fatkeqësisht ai projekt dështoi si rezultat i dështimit të tenderit.

Për të gjitha pikat dhe ndërlidhjen e tyre me zyret qendrore jemi duke i shfrytëzuar pajisjet “Fortigate Firewall” që si funksion primar kanë filtrimin e trafikut dhe mbrojtjen nga sulmet, virusët etj, por që gjithashtu kanë edhe funksione të tjera sikurse “routing”, “VPN” tunele, etj. Këta përdoren në Zyrtar Qendrore si dhe në zyrtar e administratës në të gjitha njësitë, ndërsa për pikat tjera sikurse arkat dytësore përdorim programin “FortiClient” sikurse në vazhdim.

Për shumë nga kolegët dhe bashkëpunëtorët tonë, në dy pajisjet kryerore në zyret qendrore kemi krijuar kredencialet e nevojshme për të mundur lidhjen, pastaj kemi konfiguruar kompjuterët e tyre duke instaluar programin “FortiClient” dhe duke kryer konfigurimet e nevojshme për ta bërë të mundur që këta të kenë qasje në sistemet tona nga distanca, në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar.

Lidhje dhe qasje e tillë është krijuar për:

- a) Rinor Rexhaj – Informatika Computers,
- b) Nijazi Qitaku – Informatika Computers,
- c) Arta – Informatika Computers,
- d) Besnik Zeqiraj – Hidrodrini - Laptop,
- e) Selami Berisha – Hidrodrini - Laptop,
- f) Fiona Gashi – Hidrodrini – kjo qasje është krijuar specifikisht për një periudhë të caktuar kohore,
- g) Niman Beqiraj – Hidrodrini – Laptop,
- h) Angjelina Krasniqi – Hidrodrini Arka te Komuna Pejë – tashmë kjo qasje përdoret nga Melisa Bojku,

- i) Agron Nikqi – Hidrodrini – Hidrodrini Arka te Stacioni i Policisë së trafikut, tashmë kjo qasje përdoret nga Sabrije Rrustaj,
- j) Nedzat Pepiq – Hidrodrini – Arka Vitomericë,
- k) Fatbardha Nurqaj – Hidrodrini – Arka Gurrakoc,
- l) Islam Mazrekaj – Hidrodrini – Arka Deçan,
- m) Floriela Devolli – Hidrodrini – Arka Deçan,
- n) Fazli Rexhaj – Istog,
- o) Muhamet Shatri – Istog.




Figura 4: - paraqet “tunelet VPN” pra lidhjen aktuale të qastit në kohë reale me detaje.

* Një hallkë e dobët sa i përket sigurisë janë pajisjet ekzistuese për internet pa tel (“wireless routers”). Sikurse në zyrat qendrore e ashtu edhe në Njësitë Operative, sepse ne kemi pajisje të lira dhe nga prodhues të ndryshëm që janë blerë gjatë viteve sipas nevojave. Këto pajisje tashmë janë vjetërsuar dhe nuk ofrohet mbështetje (freskime të “firmware”) nga prodhuesit dhe kjo paraqet rrezik potencial për sa i përket sigurisë. Këto duhet të hiqen nga përdorimi dhe të zëvendësohen me pajisje më të reja dhe të cilat kanë mbështetje nga prodhuesit.

3.3 Ormanët metalik dhe kamerat

Përgjatë vitit 2025 në këto lokacione kemi vendosur/montuar ormanët metalik të cilët përdoren për të mbartur dhe ruajtur pajisjet e rrjetit sikurse “Fortigate Firewall”, “Switch” apo “wireless router” dhe pajisjet tjera sikurse “DVR” për kamera etj.

Ormanë metalik (“Rack cabinet”) gjatë vitit 2025 kemi montuar në këto lokacione:

- Zyret e reja NJO Istog – këtu edhe e kemi shtrirë kabllo dhe kemi krijuar rrjetën e brendshme “LAN” në të cilën lidhen kompjuterët, shtypësit dhe pajisjet tjera që kanë nevojë rrjetë,
- Arka te Qarshia e Gjatë – NJO Pejë,
- Zyret e administratës – NJO Junik,
- Objekti te Rezervuari – NJO Pejë,
- Fabrika e Trajtimit të Ujit të Pijshëm në NJO Klinë.

Në përputhje me propozimin e Kryeshefit Ekzekutiv, gjatë vitit 2025 kemi instaluar kamera të vëzhgimit në këto lokacione:

- Zyret e reja në NJO Istog kemi instaluar dy (2) kamera të vëzhgimit: njëra që ka pamje mbi Arkë ku bëhen pagesat dhe tjetra në drejtim të pajisjes së regjistrimit të hyrje-daljeve,
- Në zyrën Qendrore kemi instaluar në korridor një (1) kamerë të vëzhgimit që ka pamje në pajisjen e regjistrimit të hyrje-daljeve,
- Te Burimi Drini i Bardhë i kemi instaluar dy (2) kamera të vëzhgimit,
- Në objektin te Klorinatori në Radavc, i kemi instaluar dy (2) kamera të vëzhgimit.
- Te objekti i klorinimit në Vrellë, NJO Istog, i kemi instaluar dy (2) kamera të vëzhgimit,

- Edhe një kamerë e cila ka qenë e dëmtuar e kemi ndrruar me një të re, është fjala për kamerën në hyrje të Zyreve Qendrore.

Shënim: këto kamera që i përmendëm sipër janë kamera të pavarura, pra nuk janë të lidhura me sistem klasik përmes pajisjes regjistruese DVR, në ato kemi vendosur nga një kartelë “Micro SD Card” në të cilat bëhet incizimi. Janë të qasshme në çdo kohë por vetëm për personat që autorizohen nga KE në bazë të kompetencave të tyre dhe nevojave të kompanisë.

Pas kryerjes së punëve nga ana e kontraktorëve në objektet te Fundërruesi në Klinikë, zyrja e TI-së është angazhuar dhe ka pranuar në menaxhim sistemin e vëzhgimit me kamera, siç është kërkuar nga Kryeshefi Ekzekutiv. Kemi rënë në kontakt me personat përgjegjës të Kompanisë e cila i ka kryer punimet aty dhe na janë bartur të drejtat e qasjes në sistemin e kamerave. Pas disa ditëve, kemi vërejtur se po ka vazhdimisht probleme me tri (3) nga gjithsejtë gjashtë (6) kamerat e instaluar dhe kështu na është dashur që të shkojmë dhe identifikojmë problemin. Pas inspektimit kemi vërejtur që duhet të ndërrohen dy (2) kablllo që nga objekti ku është administrata e deri në shtyllën ku ishin vendosur dy (2) kamera më largësi mbi 50m secila, veprime të cilat edhe i kemi kryer. Ndërsa për kamerën e tretë (3) na është dashur që të ndërrojmë të ashtuquajturit konektorë për të eliminuar pengesat. Më vonë, në këtë sistem të kamerave duke u bazuar në kërkesat e Njësisë si dhe miratimin nga Kryeshefi Ekzekutiv i kemi shtuar edhe dy (2) kamera për të mbuluar me vëzhgim hapësirat shtesë.

4. Telefonat mobil dhe shtypësit termik për leximet dhe shtypjen e faturave në terren

4.1 Telefonat mobil

Gjatë vitit, disa nga lexuesit që nuk kanë pasur janë pajisur me telefonë të mençur në të cilët paraprakisht e kemi instaluar në bashkëpunim me kompaninë Informatika Computers programin për leximin e ujmëmatësve në terren, e për disa të tjerë i kemi zëvendësuar pasi që ishin dëmtuar gjatë punës në terren, sipas kërkesës dhe miratimit nga drejtori komercial.

4.2 Leximet dhe shtypja e faturave në terren

Leximi dhe shtypja e faturave në terren është një projekt që si zanafillë me hapa konkret ka vitin 2020 kur edhe e kemi publikuar një tender për blerjen e disa pajisjeve të TI-së e ndër to edhe dhjetë (10) shtypës (printer) termik për shtypjen e faturave në terren. Që nga ajo kohë kompania “Informatika Computers” ka qenë duke bërë përgatitjet e nevojshme në databazë si dhe në aplikacionin ekzistues të lexuesve. Në mesin e vitit 2025 së bashku me kompaninë “Informatika Computers” dhe departamentin komercial kemi përfunduar dizajnin dhe përmbytjen përfundimtare të faturës që do të shtypet përmes “shtypësve termik” nga ana e inkasantëve në terren. Për këtë janë kryer disa teste (të sinkronizimit të leximeve në terren dhe shtypjes së faturës) paraprakisht në muajin qershor, dhe në fillim të muajit korrik kemi filluar me zbatimin e këtij procesi në praktikë; pra, leximin dhe shtypjen e faturave në terren me vetëm një lexues në NJO Pejë. Më vonë, në fund të vitit, leximin dhe shtypjen e faturave në terren kemi filluar që ta zbatojmë edhe në NJO Istog fillimisht me dy lexues e pastaj do ta zgjerojmë këtë proces edhe në Njësitë tjera. Plani fillestar para shumë vitesh kur edhe është konceptuar ky proces si ide me të cilin edhe unë jam pajtuar ka qenë që në të pesë (5) Njësitë Operative të fillohet së pari me nga dy lexues ($5 \times 2 = 10$ shtypës) e mandej pas identifikimit të sfidave potenciale dhe zgjidhjes së tyre të blejmë shtypës (“printer”) termik shtesë – për të gjithë lexuesit dhe ta shtrijmë leximin dhe shtypjen e faturave në terren në tërë kompaninë, mirëpo departamenti komercial është duke insistuar që kjo të zbatohet në NJO Istog fillimisht me të gjithë shtypësit ekzistues e mandej të vazhdojmë me njësitë tjera. Sido që të jetë ne – zyra e TI-së jemi të gatshëm dhe jemi duke e mbështetur këtë proces.

* **Ky projekt** i cili është duke funksionuar me një lexues në NJO Pejë që nga Korriku 2025 dhe me dy lexues në NJO Istog nga Dhjetori 2025 **konsiderohet projekt i suksesshëm dhe me shumë vlerë për kompaninë tonë.**

5. Ueb-faqja e kompanisë

Përgjatë vitit, ueb-faqja e kompanisë sonë është pasuruar me materiale të ndryshme në kategori të ndryshme.

Në përputhje me kërkesën e dërguar tek Kryshefi Ekzekutiv nga Agjencia për Informim dhe Privatësi dhe sipas udhëzimeve të Kryshefit ne kemi ndërmarrë këto hapa në vazhdim për të përmbushur kërkesat që kanë të bëjnë me ueb-faqen tonë zyrtare:

- Janë shtuar biografitë e menaxhmentit të kompanisë,
- Janë shtuar të dhënat për drejtuesit e departamenteve,
- Janë shtuar të dhënat kontaktuese për: Zyrtaren përgjegjëse për qasje në dokumente publike,
- Janë shtuar të dhënat kontaktuese për: Zyrtaren përgjegjëse për Sinjalizim.

Sipas udhëzimeve të Sekretarit të Kompanisë, në strukturën e ueb-faqes së kompanisë sonë e kemi krijuar një “Meny” (ndërfaqe) të re, të cilën e kemi emëruar “Konsumatorët”, e në të cilën kemi shtuar disa prej shpjegimeve të kërkuara së bashku me inkuadrimin edhe të tre formularëve shtesë:

1. Deklaratë për ndërrimin e “Emrit në Faturim”,
2. Formulari për ankesë, dhe
3. Formulari i aplikacionit për lidhje (në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit)



Figura 5: paraqet ndryshimet dhe formularët e inkuadruara për konsumatorët

E gjithashtu në strukturën e ueb-faqes në përputhje me rekomandimet e Sekretarit të Kompanisë e kemi krijuar një “Vegëz” të veçantë të quajtur “Prokurimi” brenda së cilës i kemi grupuar edhe këto kategori:

- Planifikimet vjetore,
- Ftesë për kuotim,
- Njoftimet për kontratë,
- Njoftimet për dhënie e kontratës,
- Njoftimet për anulim,
- Njoftimet për nënshkrim të kontratës dhe
- Kontratat e nënshkruara.

në të cilat kemi filluar që t'i publikojmë dokumentet përkatëse.




Figura 6: paraqet menynë “Prokurimi” dhe dokumentet e publikuara sipas kategorive

6. Pagesat “online” për faturat e shërbimeve të kompanisë sonë

6.1 Pagesat përmes “ueb-faqes” së Kompanisë sonë

Konsumatorët tonë janë duke vazhduar që të regjistrohen dhe të kryejnë pagesa përmes “ueb-faqes” së kompanisë sonë.

*** Ky është një projekt i rëndësishëm, gjithashtu pjesë e digitalizimit të shërbimeve tona dhe ndikon në rritjen e inkasimit.**

6.2 Pagesat përmes platformës “eKosova”

Konsumatorët tonë janë duke vazhduar që të kryejnë pagesa përmes platformës “eKosova”. Që nga fillimi vlera e pagesave që kryhen përmes platformës “eKosova” ka qenë vazhdimisht më e madhe sesa ato në “ueb-faqe”. Një detaj tjetër i rëndësishëm që paraqet mospasqyrim të saktë por vetëm nga ana statistikore është që për disa nga konsumatorët tonë që kryejnë pagesa të faturave për shërbimet tona në platformën “eKosova” por që kanë llogari në Bankën TEB, pagesat e tyre nuk janë duke u paraqitur në deklaratën e Bankës ProCredit (ku pasqyrohen pagesat e kryera në platformën “eKosova”) por në deklaratën e bankës TEB. Këtë e kemi vërrejtur me Bujarin nga departamenti komercial, në disa raste kur konsumatorët na kanë dërguar dëftesat për pagesën e kryer në “eKosova”. Pra për të mos krijuar konfuzion, pagesat janë duke u regjistruar por vetëm për neve nga ana statistikore është duke u zvogëluar vlera e pagesave në raportet tona sa i përket atyre të kryera në këtë platformë. Sidoqoftë në vazhdim po i paraqes vlerat e paguara për të dy format e pagesës për vitin 2025.

Muaji dhe viti	Pagesat Web-faqe	Pagesat eKosova
Janar 2025	972.81 €	2,800.71 €
Shkurt 2025	1,730.23 €	3,321.77 €
Mars 2025	1,086.79 €	3,920.40 €
Prill 2025	1,291.58 €	3,132.41 €
Maj 2025	1,605.44 €	4,292.88 €
Qershor 2025	1,383.64 €	2,950.74 €
Korrik 2025	1,493.80 €	4,839.42 €
Gusht 2025	999.46 €	4,454.42 €
Shtator 2025	1,057.74 €	4,072.80 €
Tetor 2025	792.80 €	3,355.12 €
Nëntor 2025	1,057.69 €	4,391.78 €
Dhjetor 2025	1,395.87 €	2,947.35 €
Total	14,867.85 €	44,479.80 €

Figura 7: paraqet vlerat e pagesave në “ueb-faqe” si dhe në platformën “eKosova” për vitin 2025.

* Ky është një projekt i rëndësishëm, gjithashtu pjesë e digjitalizimit të shërbimeve tona dhe ndikon në rritjen e inkasimit.

6.3 Komponenta/aplikacioni mobil “eHidrodrini” për pajisjet e mençura me sistem Android dhe iOS

Kërkesë e vazhdueshme e jona (Kryeshefit Ekzekutiv dhe IT-së) që i është paraqitur kompanisë Informatika ka qenë që programi ekzistues Rikont të zgjerohet edhe me zhvillimin e aplikacionit për përdorim në pajisjet mobile (pajisjet “smart”), nga ku konsumatorët do të mund të shohin faturat e tyre dhe t’i paguajnë ato për shërbimet e kompanisë sonë. Pas disa prezantimeve të verzioneve të ndryshme që përfshinin përmbushjen e vetëm disa prej kërkesave tona aplikacioni “eHidrodrini” u lansua dhe u bë publik në Maj të vitit 2025.

Për udhëzime sesi konsumatorët mund ta shkarkojnë aplikacionin “eHidrodrini” dhe sesi mund të regjistrohen për ta përdorur kam hartuar një udhëzues me shpjegime dhe figura të cilin e kam publikuar në ueb-faqen e kompanisë sonë e të cilin mund ta gjeni në këtë lidhje: <https://kruhidrodrini.com/udhezuesi-per-perdorimin-e-aplikacionit-ehidrodrini-per-pagesat-online-nga-pajisjet-mobile/>

Gjithashtu, për përdorimin e aplikacionit kam krijuar një video-udhëzues dhe e kam publikuar në “ueb-faqen” e kompanisë sonë, të cilin mund të gjeni në këtë lidhje: <https://kruhidrodrini.com/video-udhezues-perdorimi-i-aplikacionit-ehidrodrini-per-pagesa-online-2/>

* ky projekt është pjesë e digjitalizimit të shërbimeve dhe konsiderohet ndër sukseset më të rëndësishme për kompaninë tonë e që ka ndikim edhe në rritjen e inkasimit

Në vazhdim do t’i paraqesim disa nga statistikatat që kanë të bëjnë me këtë aplikacion.

Muaji	Numri i kërkesave për llogari	Llogaritë e konfirmuara	Numri i pagesave të kryera	Vlera gjithsejtë	Mesatarja e pagesës
	eHidrodrini	eHidrodrini	eHidrodrini	eHidrodrini	eHidrodrini
Maj 2025			2	7.00 €	3.50 €
Qershor 2025	214	185	21	693.76 €	33.04
Korrik 2025	181	168	78	2,031.81	26.05
Gusht 2025	177	159	77	1,727.48	22.43
Shtator 2025	105	98	92	1,988.48	21.61
Tetor 2025	127	121	93	2,383.47	25.63
Nëntor 2025	118	91	82	1,968.79	24.01
Dhjetor 2025	138	104	141	2,809.53	19.93
Gjithsejtë:	1060	926		13,610.31 €	

Figura 8: paraqet statistika për përdorimin e aplikacionit “eHidrodrini”

Për ta spjeguar, që nga muaji Maj 2025 kur e kemi lansuar aplikacionin së paku 1,060 konsumatorë e kanë instaluar atë në pajisjet e tyre mobile (pajisjet “smart”) dhe kanë dërguar kërkesë për krijimin e llogarisë, nga të cilët: 926 e kanë konfirmuar hapjen e llogarisë. Të tjerët me shumë gjasa gjatë fazës së regjistrimit kanë gabuar

në përshkrimin e saktë të postës elektronike (e-mail adresës së tyre) ose ajo adresë e tyre nuk është me aktive e kështu edhe nuk kanë mundur që ta konfirmojnë hapjen e llogarisë.

Nga muaji Maj, përkatësisht Qershor 2025 e deri më 31 dhjetor 2025 janë kryer pagesa përmes aplikacionit “eHidrodrini” në vlerë totale prej 13,610.31 Euro.

Nga koha që është lansuar ky aplikacion janë bërë edhe disa avancime të tij për të përmbushur kërkesat tona, por **përkundër presionit tonë** mbesin edhe disa shumë të rëndësishme për t’u zbatuar në të ardhmen. Fuqimisht besojmë se pagesat përmes aplikacionit “eHidrodrini” do të rriten atëherë kur përmbushen së paku këto të paraqitura në vazhdim, e të cilat nuk janë realizuar deri më 31 dhjetor 2025:

- a) **Shtimi i më shumë se një llogarie (Nr. i konsumatorit) brenda aplikacionit.** – Pra, për rastet kur një konsumatorë ka më shumë se një pronë (ujëmatës), me ç’rast konsumatorët do ta kenë mundësinë që t’i regjistrojnë ato brenda një llogarie të krijuar në pajisjet mobile e kështu edhe të paguajnë për secilen llogari. – **Kështu si është aplikacioni aktualisht** për secilën pronë konsumatori duhet ta krijojë nga një llogari, gjë që është shumë e mundimshme për ata **andaj edhe ka hezitim.**
- b) Mundësia e shkarkimit të faturave mujore,
- c) Mundësia e shkarkimit të dëftesës për pagesën e kryer si dhe dërgimi i saj në e-mail adresën përkatëse,
- d) Sinkronizimi automatik në sistemin Rikont, për pagesat që kryhen nga ana e konsumatorëve në aplikacionin “eHidrodrini” dhe pasqyrimi i menjëhershëm i pagesës në aplikacion,
- e) Njoftimet për faturat e reja,
- f) Njoftimet për versionet e reja të aplikacionit – përditësimet, e të tjera.

*** Ky është një projekt shumë i rëndësishëm, gjithashtu është pjesë e digjitalizimit të shërbimeve tona dhe ndikon fuqishëm në rritjen e inkasimit.**

Në vazhdim po e japim një përmbledhje për pagesat “online” prej se janë funksionalizuar ato.

Burimi i pagesës	2023	2024	2025	Sipas burimeve
"ueb-faqe"	65.29	9,548.26	14,867.85	24,481.40
"eKosova"	nuk ka ekzist	22,281.07	44,479.80	66,760.87
"eHidrodrini"	nuk ka ekzist	nuk ka ekzist	13,610.32	13,610.32
	65.29	31,829.33	72,957.97	

Vlera e përgjithshme e pagesave deri në fund të vitit 2025: **104,852.59**

Figura 9: paraqet pagesat e kryera në tërësi në të tre (3) mundësitë e pagesës “online”

7. Shtypja e faturave standarde – bashkëpunimi me departamentin komercial

Përgjatë vitit kemi vazhduar të mbështesim të gjitha departamentet dhe personelin e kompanisë e në veçanti departamentin komercial.

Për shkak të vonesave të shkaktuara nga Posta e Kosovës në procesin e shtypjes, zarfimit dhe shpërndarjes së një pjese të faturave për Kompaninë tonë, e edhe përkundër shumë vërejtjeve tona, takimeve të përbashkëta të mbajtura për këtë çështje e premtimeve të tyre por pa rezultat konkret, kompania e jonë përmes departamentit komercial është detyruar që ta pezullojë këtë proces. – Vendimi është marr me datën 25.02.2025. Pra, si rrjedhojë nga ky vendim nga muaji shkurt 2025 është ndërprerë procesi i zarfimit dhe shpërndarjes së faturave përmes Postës së Kosovës.

Gjithashtu, me aktivizimin e shtypjes së faturave në teren nga ana e lexuesve përmes shtypësve termik, tashmë është zvogëluar edhe numri i faturave të cilat i shtypim, dhe do të vazhdojë të zvogëlohet edhe në të ardhmen.

Muaji	Sasia
Janar 2025	66,373
Shkurt 2025	59,654
Mars 2025	59,827
Prill 2025	60,067
Maj 2025	60,257
Qershor 2025	59,515
Korrik 2025	59,408
Gusht 2025	59,710
Shtator 2025	59,763
Tetor 2025	60,272
Nëntor 2025	60,356
Dhjetor 2025	58,999
Gjithsejtë:	724,201

Figura 10: paraqet në copë numrin e faturave të shtypura sipas muajve për tërë kompaninë.

8. Procesi i digjitalizimit të dokumenteve zyrtare

Me iniciativë të Sekretarit të Kompanisë dhe miratim nga Kryeshefi Ekzekutiv në muajin Prill është formuar komisioni për nisjen e procesit të digjitalizimit të dokumenteve zyrtare të Kompanisë përmes skanimit të tyre.

Si zyre e TI-së kemi marr këto veprime për të mbështetur këtë proces:

- Në infrastrukturën e Kompanisë (në “Domain Controller”) kemi krijuar një përdorues (“User”), i cili do të mund të përdoret për procesin e skanimit.
- E kemi ndarë një kompjuter (“laptop”) i cili do të mund të përdoret për këtë proces. “Llaptopi” mund të përdoret me kredencialet tashmë të krijuara, e të cilat do t’u japim personave të autorizuar gjatë procesit të skanimit të dokumentacionit.
- Në “laptop” i kemi krijuar disa “follderë” sikurse në grafikën në vazhdim, ku do të mund të vendosen dokumentet e skanuara, e emërtimet e të cilave mund të ndryshohen apo edhe shtohen të tjerë sipas nevojës.




Figura 11: paraqet një formë të mundshme të klasifikimit të dokumenteve të skanuara

- Në shtypësin (“printerin”) industrial të cilin e përdorim për shtypjen e faturave dhe i cili e ka edhe funksionin e skanimit, i kemi kryer konfigurimet e nevojshme dhe e kemi testuar tashmë procesin e skanimit.




Figura 12: paraqet pamje nga shtypësi “printeri” i konfiguruar për skanim të dokumenteve.

Gjithashtu, kurdo që të jetë e nevojshme do t’i konfigurojmë edhe shtypësit tjerë në cilëndo Njësi Operative që komisioni ka nevojë të kryejë skanimet e dokumentacionit.

Këto që u thanë sipër janë vetëm disa prej aktiviteteve kryesore të zyrës së TI-së në formë të përmbledhur, andaj nëse iu nevojiten më shumë hollësi, mund të shiqoni raportet mujore.

Me respekt,

Selami Berisha
Manxher i zyrës së TI

KRU "HIDRODRINI" SH.A. - PEJË
STRUKTURA ORGANIZATIVE
2023

